



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljehen/Prodato Received/Delivered	21. 09. 2023	viti god. year	3
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	6182/2023	Shlopja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
			1/4



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1068/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1068/2023 të datës 08.08.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë rr. [redacted], kundër organit të punësimit Inspektorati i Punës në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nen paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 21.09.2023, mori këtë

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1068/2023, e datës 08.08.2023, e parashtruar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] me datë 08.08.2023, me numër protokolli 5586/2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore kundër vendimit me numër Nr.127/2023 të Inspektoratit të Punës, lidhur me refuzimin e aplikacionit në verifikim paraprak, pasi që ankuesi kishte aplikuar në pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Koordinim Rajonal" në Inspektoratin e Punës në Gjilan.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.08.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Inspektorati i Punës, ndërsa Këshilli më datë 16.08.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Inspektorati i Punës, me shkresat e bashkangjitura.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr. protokollin 5586/2023 të datës 08.08.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin nga Simbnj për [redacted] të datës 12.07.2023; Njoftimin nga Simbnj për [redacted] të datës 31.07.2023; Konkursin me numër reference RN00011780 të shpallur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Inspektorati i Punës Lëvizje brenda kategorisë të datës 05.06.2023 për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Koordinim Rajonal"; Vendimin me nr.127/2023 të datës 04.07.2023 të Inspektoratit të Punës; E-mail nga [redacted] për [ankesa.kpmshck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gov.net) i datës 08.08.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë të datës 15.08.2023; Përgjigje në ankesë e datës 16.08.2023; Vendimin për formimin e komisionit të vlerësimit të kandidatëve me numër protokollin 1758 të datës 13.07.2023 të Inspektoratit të Punës; Listën e ngushtë me numër protokollin 129/2023 të datës 04.07.2023; Listën e ngushtë përfundimtare me numër protokollin 148/2023 të datës 12.07.2023; Njoftim për kandidatin fitues me numër protokollin 150/2023 të datës 19.07.2023; Shkresë me numër protokollin 158/2023 të datës 31.07.2023 e Inspektoratit të Punës; Aplikacioni i datës 20.06.2023 i kandidatit [redacted]; Akt emërim me numër protokollin 23114 të datës 30.07.2018 për [redacted]; Letërnjoftim i [redacted]; Vërtetim për [redacted] i datës 20.06.2023 i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Kamenicës; Diplomë me numër 12-1587-04/91 të datës 20.03.2012 nga Universiteti Shtetëror i Tetovës- Fakulteti Juridik për [redacted]; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publikë për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i datës 30.01.2023 për [redacted]; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i datës 31.12.2021 për [redacted]

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [redacted] është e palejuar, *sepse*:

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi [redacted] sipas Akt Emërimit me numër protokollin 02-23114 të datës 30.07.2018 është i punësuar në pozitën e punës "Udhëheqës i sektorit për Inspektim" në Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Inspektorat në komunën e Kamenicës. Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, Inspektorati i Punës me datë 05.06.2023 ka bërë njoftimin për konkursin Lëvizje Brenda Kategorisë për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Koordinim Rajonal" në Inspektoratin e Punës. Ankuesi me datë 20.06.2023 ka aplikuar për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Koordinim Rajonal" në Inspektoratin e Punës. Ndërsa Inspektorati i Punës ka nxjerr vendim me numër Nr.127/2023 me të cilin ankuesit i ka refuzuar aplikacionin me arsyetimin se i njëjti në aplikacionin e tij nuk ka paraqitur dëshmi për trajnimet e kryera si kriter konkursi.

Lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesit, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave materiale konstaton se me datë 04.07.2023 ankuesi është njoftuar se mund të parashtror ankesë në pajtim me Rregulloren 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa ankuesi nuk ka ofruar asnjë provë me të cilën dëshmohet se ka parashtruar ankesë të brendshme pranë Komisionit për Vlerësimin e Lëvizjes Brenda Kategorisë, ndërsa faktin se ankuesi nuk ka parashtruar ankesë të brendshme e ka konfirmuar edhe autoriteti punëdhënës në përgjigje në ankesë të datës 16.08.2023, si rrjedhojë



"bazuar në këtë ankuesi nuk ka vepruar sipas nenit 45 paragrafi 6 të Rregullores 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *6. Brenda shtatë (7) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrohet në shkrim pranë NJBNJ. Ankesa shqyrtohet nga NJBNJ dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj, si dhe ndërlidhur me nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 të po kësaj rregullore ku përcaktohet se: 1. Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtrojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli") . 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet.*

Bazuar në këtë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankesa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil kundër një procesi të Lëvizjes Brenda Kategorisë në Shërbimin Civil, parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës së brendshme tek institucioni siç është e përcaktuar në nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Si rrjedhojë meqenëse nuk ka asnjë dëshmi që ankuesi të ketë parashtruar ankesë të brendshme tek organi i punësimit, atëherë sipas Kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, kandidatit në procedurë të lëvizjes brenda kategorisë nuk i lejohet të parashtrojë ankesë drejtpërdrejtë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pa i shterur procedurat e brendshme të ankimimit, mbi këtë bazë ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është në kundërshtim me nenin 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i cili përcakton se: *4. Para parashtrimin të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe"*, Theksuar nga ajo që u tha më lart Kolegji konstaton se ankesa e ankuesit është e palejuar dhe nuk ka trajtuar pretendimet tjera të ankuesit.


Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.1068/2023

Çlirim Zeka  
  
Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit 
- Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës;
- Udhëheqësit të Personelit në Inspektoratin e Punës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

